

## KOMUNA E GRAÇANICËS

Graçanicë, 30.09.2024

### **Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve-programeve të OJQ-ve për fushën e kulturës – organizimi i manifestimeve të Vitit të Ri**

1. Komuna e Graçanicës u bënë thirrje të gjitha organizatave joqeveritare (OJQ), të regjistruara dhe programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës, të aplikojnë për mbështetjen financiare për zbatimin e projekteve për organizimin e manifestimeve të Vitit të Ri.

2. OJQ-të në përputhje me këtë Thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për aktivitetet e mëposhtme:

- Organizimi i programeve kulturore dhe argëtuese me rastin e festave të Vitit të Ri dhe Krishtlindjeve;
- Shpërndarja e pakove të Vitit të Ri;
- Rregullimi i rrugës kryesore në Graçanicë me rastin e festave të Vitit të Ri.

3. OJQ-ja mund të paraqesë vetëm një projekt, me të cilin do të përfshihet dhe do të kontribuojë në promovimin e aktiviteteve të parapara në pikën 2 të kësaj Thirrjeje publike.

4. Vlera e përgjithshme e planifikuar e Thirrjes publike është 50.000,00 (peshëdhjetë mijë) euro.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 5.000,00 (pesë mijë) euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 50.000,00 (peshëdhjetë mijë) euro.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimit është 15 ditë pune nga dita e publikimit të Thirrjes publike, përkatësisht dita e fillimit është 01.10.2024, ndërsa dita e fundit për dorëzimin e propozimit është 21.10.2024.

6. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare të R. Kosovës, me seli në territorin e Komunës së Graçanicës dhe të cilat veprojnë dhe janë të regjistruara së paku 2 vjet para datës së publikimit të Thirrjes publike. OJQ që paraqet aplikacion duhet të paraqesë dëshmi se është marrë në dy vitet e fundit me organizimin e manifestimeve kulturore dhe nëse ishte përfituese e mjeteve financiare nga Komuna e Graçanicës të paraqesë prova se i ka justifikuar mjetet duke dorëzuar një raport financiar.


Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në kuadër të formularit të paraparë, të cilin së bashku me Udhëzimet për aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të *Komunës së Graçanicës-[kk.rks-gov.net/gracanice](http://kk.rks-gov.net/gracanice)*. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme: *Komuna e Graçanicës, rruga "Car Lazar" p.n.10500 Graçanicë*.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, resurset, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimin për aplikuesit.

Do të konsiderohen vetëm propozimet që janë paraqitur brenda afatit për paraqitjen e aplikacioneve dhe në formë të përcaktuar me Thirrjen publike.

8. Të gjitha çështjet në lidhje me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në këtë adresë: [opstinagracanica@gmail.com](mailto:opstinagracanica@gmail.com).



Kryetarja e komunës

Prof. dr Ljiljana Šubarić

**Vendimi i dorëzohet:**

- Kabinetit të kryetares së komunës;
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
- Drejtorisë për Administratën e Përgjithshme;
- Arkivit.